



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 27 (e mbyllur)
Prishtinë, më 7 korrik 2016, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Rugova, Çerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri dhe Puhie Demaku.

Mungoi: Zafir Berisha.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Teuta Rugova, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Dëgjimi i kandidatëve të propozuar për pozitën e ambasadorit;
3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 25, 31 mars 2016 dhe 4 prill 2016;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor;
5. Shqyrtimi Propozim-vendimit për shpalljen e datës 5 Shtator - Ditë të Bamirësisë “Nëna Terezë”;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Nënkryetarja konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës, duke e hequr nga rendi ditës pikën 5 me arsyetimin se shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpalljen e datës 5 Shtator - Ditë të Bamirësisë Nëna Terezë, për shkak të vonesës të shqyrtimit nga Komisioni, është shqyrtuar nga Kryesia e Kuvendit dhe është radhitur për miratim në seancë plenare.

2. Dëgjimi i kandidatëve të propozuar për pozitën e ambasadorit

Komisioni bazuar në shkresat e MPJ-së për propozimin e kandidatëve për ambasadorë dëgjoi në seanca dëgjimore, dy kandidatët e propozuar për pozitën e ambasadorit. Seancat dëgjimore u mbajtën të mbyllura, për të cilat Komisioni do të hartojë raport në besim për Presidenten, Kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 25, 31 mars 2016 dhe 4 prill 2016

Nënkryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 25, 31 mars 2016 dhe 4 prill 2016, me vërejtjen e deputetes Blerta Deliu -Kodra se me rastin e shqyrtimit të Projektligjit ka ndodhur një lëshim lidhur me dekretimin e diplomatëve.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor

Teuta Rugova theksoi se përmes këtij Projektligji, ratifikohet Marrëveshja për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor. Fushëveprimi i këtij Projektligji është Marrëveshja për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, që është miratuar si nismë nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 12.11.2015. Projektligji ka për qëllim të promovojë zhvillimin e bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet Palëve Kontraktuese, forcimin e lidhjeve ndërmjet Palëve Kontraktuese, integrimin e Palëve Kontraktuese në Bashkimin Evropian dhe prezantimin e përbashkët të Palëve Kontraktuese në vendet e treta.

Pas diskutimeve, lidhur me Projektligjin për ratifikimin Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, nënkryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

5. Të ndryshme.

Komisioni vendosi që çështjet e parapara për shqyrtim në këtë pikë të rendit të ditës, të shqyrtohen në takimin e radhës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Teuta Rugova